



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1095

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi- Anëtar të Panelit duke vendosur sipas ankesës së OE “Delta Security SH.P.K.”, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender” me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes së Prishtinës, më 23.01.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e Delta Security SH.P.K. me nr. 2024/1095, e datës 13.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes së Prishtinës.
2. Anulohet Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunes së Prishtinës. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.09.2024, "Kuvendi i Komunes së Prishtinës", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender", me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2.130.000.00€.

Me 29.10.2024, OE Delta Security SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.11.2024, Autoriteti Kontraktues e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.11.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Delta Security SH.P.K., me nr. 2024/1095 lidhur me aktivitetin "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender", me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP-ja ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Delta Security SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Te pa kënaqur me Vendimin e AK-se - KUVENDI I KOMUNËS SE PRISHTINËS të datës 04.11.2024, me të cilën na përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit: Loti 1 - Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2 - Sigurimi fizik në objektet shëndetësore - Ri-tender me numër të Prokurimit: 616-24-10100-2-1-1, në afatin ligjor, në përputhje me nenin 109 të LPP-së, e ushtrojmë këtë ankesa pranë OSHP-së:

Për shkak se AK-KUVENDI I KOMUNËS SE PRISHTINËS:

Në mënyrë të kundërligjshme ka vendosur kërkesa diskriminuese dhe favorizuese në dosjen e tenderit, dhe kërkesën tonë për rishqyrtim e ka aprovuar pjesërisht, por nuk e ka përmirësuar dosjen e tenderit.

Sqarojmë në mënyrë të detajuar:

Tani në ankesën tonë po i ndryshojmë pretendimet ankimore pasi që AK me datën 08.11.2024 ka publikuar versionin e ri të dosjes së tenderit dhe disa pretendime tona ndryshojnë nga kërkesa për

rishqyrtim, ku i kemi hequr disa që i kemi pasur në kërkesën për rishqyrtim, por e njoftojmë ekspertin dhe panelin shqyrtues se nuk kemi shtuar pretendime të reja.

Lidhur me pretendimin 1, të cilin e kemi pasur në kërkesën për rishqyrtim, tani po e heqim pasi që AK komplet e ka përmirësuar dosjen dhe i ka eliminuar ato kërkesa diskriminuese dhe favorizuese.

Pretendimi 2: Sa i përket pretendimit për Menaxherin e Sigurimit Themelor, në përputhje me ligjin LIGJI NR. 08/L-274, Neni 16, pika 3, duhet të ketë përfunduar shkollimin e mesëm. Në dosjen e tenderit, AK ka kërkuar që Menaxheri i Sigurimit Themelor, së bashku me ndihmësit, të ketë diplomë fakulteti, e cila, njëjtë si kriteri për dritat vezulluese, është në kundërshtim me ligjin NR. 08/L-274. Neve kemi kërkuar nga AK që ta largojë këtë kriter nga kërkesat në dosjen e tenderit dhe të kërkojnë përmbushjen e kushteve në përputhje me ligjin, ashtu siç është paraparë që Menaxheri i Sigurimit Themelor të jetë i përgatitur profesionalisht. AK në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim ka potencuar se kjo kërkesë nuk është në kundërshtim me LPP-në, i kujtojmë AK-së se përgjegjësia për këtë kërkesë nuk bie në juridiksionin e LPP-së, por rregullohet me ligjin LIGJI NR. 08/L-274. Neve kemi potencuar se kjo është kërkesë në kundërshtim me ligjin NR. 08/L-274 dhe përfundimisht kjo kërkesë është diskriminuese, përkatësisht favorizuese. Andaj, AK ose duhet ta heqë ose duhet ta përmirësojë atë.

Pretendimi 3: Sipas specifikimit teknik, OE është i detyruar të deklarojë se do të punësojë minimum 84 roje sigurie për kryerjen e shërbimeve, të cilët përfshijnë edhe punëtorët ekzistues të punëdhënësit paraprak. Nëse jemi të detyruar të plotësojmë kërkesën e përshkruar tek 9.1 & 9.2, konkretisht Kërkesa 7, pika b, që kërkon listën e të punësuarve dhe përshkrimin e vendit të punës për stafin e rregullt shoqëror me kontratat e punës, ndërsa për stafin e ri kërkon para-kontrata, ju lutemi të qartësoni:

A. Nëse kjo pikë i referohet rojeve fizike, atëherë vetëm punëtorët ekzistues që janë të punësuar nga punëdhënësi paraprak do të përfshihen dhe do të mbulohen me një deklaratë.

B. Nëse i referohet stafit profesional, ata janë përfshirë vetëm tek Kërkesa 4 për stafin menaxherial.

Kjo kërkesë duhet të largohet, pasi stafi ekzistues i rojeve fizike është për shkak të volumit të madh të bashkëngjittjes së kontratave të punëtorëve aktualë. Nuk është e nevojshme, mund të kërkonte të konfirmonte me një listë të punëtorëve në trust ose forma të tjera, mirëpo jo të bashkëngjisni kontrata, pasi sistemi i EPROKURIMIT ka një hapësirë të limituar të bashkëngjittjes së dokumenteve.

Në përgjigjen e kërkesës tonë për rishqyrtim, AK ka sqaruar se ky numër është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për ta përmbushur kontratën, por nuk na e ka sqaruar se a ka nevojë vetëm për deklaratën. Pasi që në njërin anë, në dosjen e tenderit, tek specifikat teknike të detyrueshme, në faqen 26 të DT, ka vendosur kërkesën:

“Obligimet tjera të OE të vlefshme për dy lotët. OE duhet të deklarohet se do të punësojë minimum 84 roje sigurie për kryerjen e shërbimeve; nga të cilët janë punëtorët ekzistues të PUNËDHËNËSIT PARAPRAK.”

Kurse në anën tjetër, si dëshmi ka kërkuar kontrata për këta punëtorë, kur neve nuk e dimë se kush janë ata dhe nuk kemi të dhëna për ta. Kjo kërkesë është të kundërligjshme. Gjithashtu, një

kërkesë e tillë nuk është cekur në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, ndërsa në nenin 27, pika 4 e LPP-së thuhet se kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.

Gjithashtu, edhe në pikën 4 të nenit 59 të LPP-së thuhet se: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Pretendimi 4: Gjithashtu, sipas kërkesës 8, kërkohen për listën e pajisjeve faturat e blerjes dhe fotot.

Tek ky kriter mjafton deklaratë për pajisjet, meqë pajisjet janë fizikisht të pranishme dhe mund të dëshmohen me foto, por për shkak të viteve të kaluara me faturë është më e vështirë të konfirmohen.

AK edhe në të kaluarën ka pasur aktivitete të ngjashme, por e ka vendosur në dosje të tenderit në pasues ku ka pasur të drejtën e verifikimit të pajisjeve në çdo kohë nga komisioni i AK-së. Andaj, konsiderojmë se edhe kjo kërkesë e AK-së duhet të hiqet, pasi që pajisjet ekzistojnë dhe AK mund të dalë në çdo kohë dhe ti verifikojë ato. Verifikimi i pajisjeve në vendin e ngjarjes është dëshmi më e fortë sesa sjellja e disa fotove, pasi dyshojmë se shumë OE po manipulojnë me këto kërkesa dhe po i nxjerrin foto nga interneti dhe po ia ofrojnë AK-së, ndërsa AK po i merr si të mirëqena, ndërsa në realitet nuk i posedojnë fare ato pajisje. Për këtë, ne kërkojmë që AK ta heqë këtë kërkesë ose ta ndryshojë, duke i shtuar një pasues që të rezervojë të drejtën e shikimit të pajisjeve në çdo kohë.

Pretendimi 5: Gjithashtu, në lidhje me buxhetin e paraparë sipas kërkesave të DT-së dhe specifikimeve teknike të ANEKSI 1, buxheti i parashikuar nuk i përmbush kushtet e kërkuara.

Ju lutemi të përdorni formularin e korigjimeve të gabimeve B54 dhe të ndryshoni Dosjen e Tenderit, duke respektuar ligjin për kompanitë e sigurimit, në mënyrë që kërkesat të jenë në përputhje me ligjin. Po ashtu, kërkojmë të rritet buxheti për të përmbushur kriteret e parashikuara sipas përshkrimit teknik në Aneksin 1.

AK nuk ka bërë kurrfarë analize financiare që buxheti i kërkuar i plotëson kërkesat e AK-së, por vetëm ka thënë se ky buxhet mjafton sipas njësisë kërkuese. Pra, në njërin anë ka kërkuar dhe ka vendosur kërkesën si më poshtë:

"Paga minimale Bruto bazë (pa aplikimin e tatimeve, kontributeve dhe lejitimeve konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212 në fuqi), për roje fizike të angazhuar në këtë kontratë duhet të jetë jo më pak se 386 €/muaj, kurse për Zv. Menaxherin 443 € bruto dhe për Menaxherin e rojeve 500 euro bruto. Ky çmim është për ndërrimin e parë (orët e ditës)."

Kontraktori është i obliguar që të respektojë Ligjin e Punës, Udhëzimin Administrativ të MPMS Nr. 09/2013 dhe të paguajë shtesë mbi pagën Bruto bazë për ndërrimin e dytë dhe të tretë, festa, shujtën dhe sigurimin shëndetësor.

Përgjigje e Autortitetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: P.l. - "Keni aprovuar që të largohet kriteri për dritat vezulluese; megjithatë, edhe pse është dashur të përdoret formulari për gabimet në njoftimet e publikuara, kjo nuk është realizuar. Po ashtu, keni aprovuar heqjen e kriterit për Menaxher të OMA dhe të tre punonjësve të specializuar për OMA. Ky ndryshim

gjithashtu nuk është përfshirë në formularin standard të korrigjimeve".

Autoriteti Kontraktues tanimë ka publikuar korrigjimet e dosjes së tenderit. Megjithatë, në kohën e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga parashtruesi, korrigjimet ende kanë qenë në proces të publikimit. Prandaj, ky pretendim duhet të trajtohet si i bazuar në tërësi.

P.2. - "Në dosjen e tenderit keni kërkuar që Menaxheri i Sigurimit Themelor, së bashku me ndihmësit, të ketë diplomë fakulteti, e cila, njëjtë si kriteri për dritat vezulluese, është në kundërshtim me ligjin NR. 08/L-274".

Kërkesa për menaxher të sigurimit themelor është në përputhje të plotë me LPP. Për më tepër, është kërkesë bazike që mund të përmbushet nga shumica e operatorëve ekonomikë potencialë dhe të fushës. Përndryshe, kjo kërkesë është e domosdoshme për të siguruar që tenderuesi fitues do të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për të realizuar me sukses kontratën për të cilën po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit.

P.3. - "Sipas specifikimit teknik, OE është i detyruar të deklarojë se do të punësojë minimum 84 roje sigurie për kryerjen e shërbimeve, të cilët përfshijnë edhe punëtorët ekzistues të punëdhënësit paraprak. Nëse jemi të detyruar të plotësojmë kërkesën e përshkruar tek 9.1 & 9.2, konkretisht Kërkesa 7, pika b, që kërkon listën e të punësuarve dhe përshkrimin e vendit të punës për stafin e rregullt shoqëror me kontratat e punës, ndërsa për stafin e ri kërkon para-kontrata, ju lutemi të qartësoni. Kjo kërkesë duhet të largohet, meqë stafi ekzistues i rojeve fizike është për shkak të volumit të madh të bashkëngjijtes së kontratave të punëtorëve aktualë dhe nuk është e nevojshme. Mund të kërkonti të konfirmoni me një listë të punëtorëve në trust ose forma tjera, mirëpo jo të bashkëngjijni kontrata, sepse sistemi i EPROKURIMIT ka një hapësirë të limituar për bashkëngjijtjen e dokumenteve".

Numri i punonjësve të kërkuar me dosje të tenderit është absolutisht i domosdoshëm për të siguruar që tenderuesi fitues do të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për të realizuar me sukses kontratën për të cilën po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit. Në anën tjetër, dëshmitë e kërkuara dokumentare janë dëshmitë më bazike përmes të cilave autoriteti kontraktues do të mund të konfirmojë me siguri nëse njëri ose tjetri tenderues e përmbushë ose jo kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit.

P.4. - "Gjithashtu, sipas kërkesës 8, kërkohen për listën e pajisjeve faturat e blerjes dhe fotot. Tek ky kriter mjafton deklaratë të pajisjeve, meqë pajisjet janë fizikisht dhe mund të dëshmohen me foto, por për shkak të viteve me fatura është më vështirë të konfirmohen".

Pajisjet e kërkuara janë absolutisht të domosdoshme për të siguruar që tenderuesi fitues do të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për të realizuar me sukses kontratën për të cilën po zhvillohet ky aktivitet i prokurimit. Në anën tjetër, dëshmitë e kërkuara dokumentare janë dëshmitë më bazike përmes të cilave autoriteti kontraktues do të mund të konfirmojë me siguri nëse njëri ose tjetri tenderues e përmbushë ose jo kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit.

P.5. - "Gjithashtu, në lidhje me buxhetin e parashikuar sipas kërkesave të DT-së dhe specifikimeve teknike të ANEKSI 1, buxheti i parashikuar nuk i përmbush kushtet e kërkuara".

Vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar nga njësia kërkuese në përputhje me nevojat dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Buxheti është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj, kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si pjesërisht e bazuar

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21.11.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1095/2024, ndërsa me datë 06.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/1095 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, "Autoriteti kontraktues nuk është përgjegjës rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE është pajtuar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli Shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Delta Security SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1095 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar qëllimin e nenit 1 të LPP-së. Ekspertja sqaron se qëllimi i këtij neni është të sigurojë përdorimin më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur. OE ankues pretendon se disa kritere të vendosura në dosjen e tenderit bien në kundërshtim me këtë qëllim. Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuar, pasi disa kritere duhet të modifikohen për të qenë në përputhje me qëllimin e nenit 1 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenin 6 të LPP-së. Ekspertja sqaron se qëllimi i këtij neni është të sigurojë përdorimin më ekonomik të fondeve publike dhe burimeve publike, duke i përdorur vetëm për qëllimet e kontratës publike. OE ankues ka përmendur këtë dispozitë pa e specifikuar se çfarë nuk është në harmoni me të. Pas shqyrtimit të pretendimeve lidhur me fondet publike dhe kritereve, ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, që ka për qëllim trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik dhe transparencën gjatë procedurave të prokurimit. Ekspertja sqaron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar, dhe disa nga pretendimet lidhur me këtë dispozitë do të shqyrtohen më gjerësisht më poshtë.

Përgjigje në Pretendimet nr. 4, 5 dhe 6:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenet 10, 11 dhe 25 të LPP-së. Ekspertja sqaron se këto nene udhëzojnë për transparencë në trajtimin e operatorëve ekonomik dhe informacioneve, si dhe trajnimin e zyrtarëve të prokurimit. OE ankues ka përmendur këto dispozita pa specifikuar çfarë nuk është në harmoni me to. Ekspertja konstaton se pretendimi është i pa-bazuar.

Përgjigje në Pretendimet nr. 7, 8, 9 dhe 12:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenet 27, 51, 69 të LPP-së dhe nenin 17.7 të Rregullores nr. 001/2022. Ekspertja sqaron se disa prej këtyre pretendimeve janë hequr nga OE ankues, ndërsa disa kritere, siç është kërkesa për diplomën universitare për menaxherët e projektit, janë në kundërshtim me ligjin për shërbimet private të sigurisë. Kriteri duhet të modifikohet dhe ekselencia konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 10:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-së për zgjidhjen preliminare të mosmarrveshjeve. Ekspertja sqaron se procesi i rishqyrtimit dhe zgjidhjes së mosmarrveshjeve është zbatuar, dhe ky pretendim është i pa-bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 11:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenin 4.3 të RRPP-së, që kërkon që aktivitetet e prokurimit të udhëhiqen në përputhje me parimet bazike të konkurrencës, efikasitetit, drejtësisë dhe transparencës. Ekspertja sqaron se pretendimi është pjesërisht i bazuar dhe lidhur me pretendimet e tjera që janë trajtuar si të bazuara dhe të pa-bazuara.

Përgjigje në Pretendimin nr. 13:

OE "Delta Security SH.P.K." pretendon se A.K., Kuvendi i Komunës së Prishtinës, nuk ka respektuar nenin 97 të RRPP-së, që udhëzon autoritetet kontraktuese në lidhje me shkeljet e rënda. Ekspertja nuk ka përmendur detajet përkatëse dhe nuk është dhënë një arsyetim i qartë nga OE ankues, prandaj ky pretendim është i pa-bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-së lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperti shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik në objektet shëndetësore- Ri-tender”, me numër të prokurimit 616-24-10100-2-1-1. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas të gjeturave në raportin e ekspertit shqyrtues.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Delta Security SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: